



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



ZRRE/Rregulla Nr. 03/2023

RREGULLA PËR VET-KONSUMATORËT ME BURIME TË RIPËRTRITSHME

18 gusht 2023



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, sipas autoritetit të dhënë dhe në pajtim me Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, Nenin 25, Neni 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084, Nenin 13 dhe 17 të Ligjit për Energjinë Nr. 05/L-081, Nenin 2 të Ligjit Nr. 08/L-201 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 05/L-081 të Energjisë dhe Vendimin Nr. prot. 2365 të datës 13.07.2023 të nxjerr nga Ministria e Ekonomisë e Republikës së Kosovës, në seancën e mbajtur më 18 gusht 2023, miratoi:

RREGULLËN PËR VET - KONSUMATORËT ME BURIME TË RIPËRTËRISHME

KREU I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Kjo Rregull përcakton parimet dhe mekanizmin e rregulluar për mbështetjen e konsumatorëve të energjisë elektrike që dëshirojnë të gjenerojnë energji elektrike në ambientet e tyre bazuar në teknologjinë e ripërtëritshme për përdorim vetanak.
2. Ndërtimi i kapaciteteve Vetë-gjeneruese mund të bëhet vetëm nëse Aplikuesi merr Vendimin për lëshimin e Autorizimit në përputhje me kërkesat e Rregullës Nr.03/2022 për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të Reja Gjeneruese, të miratuar nga ZRRE.
3. Kjo Rregull:
 - 3.1. Përcakton parimet e mbështetjes së Prosumatorëve dhe procedurën e aplikimit për t'ubërë Prosumator;
 - 3.2. Përcakton Skemën Mbështetëse të Faturimit Neto;
 - 3.3. Përcakton tarifën e Prosumatorëve si një kontribut adekuat në uljen e ndikimit të tyre në koston e sistemit energjetik;
 - 3.4. Përcakton kërkesat minimale teknike për instalimet e teknologjisë së ripërtëritshme të Prosumatorëve;
 - 3.5. Rregullon mekanizmin e Prosumatorëve që veprojnë Bashkërisht për banesat/ndërtesat kolektive.

Neni 2 Përkufizimet

1. Shprehjet e mëposhtme janë përdorur në këtë Rregull kanë kuptimet si më poshtë:
 - 1.1. “**Aplikues**” – nënkupton konsumatorin e energjisë elektrike që dëshiron të bëhet vet-



gjenerues për vet-konsum nga burimet e Ripërtërishme sipas kësaj Rregulle.

- 1.2. **“Vet-konsumator i burimeve të Ripërtërishme”** (në tekstin e mëtejshëm: **Prosumator**) - nënkupton konsumatorin fundor që operon brenda hapësirave të tij të vendosura brenda kufijve të ngushtë, që prodhon energji elektrike të Ripërtërishme për konsum vetanak, si dhe i cili mund të ruajë ose shesë energji elektrike të Ripërtërishme të prodhuar nga vetë ai, me kusht që, për një vetë-konsumator të burimeve të Ripërtërishme jo-familjar, këto veprimtari nuk përbëjnë veprimtarinë e tij kryesore tregtare ose profesionale.
- 1.3. **“Objekti i vet-konsumatorëve me burime të Ripërtërishme”** - nënkupton objektin e gjenerimit të instaluar në një ambient të konsumatorit përfundimtar dhe të lidhur me instalimet e brendshme të konsumatorit, të vendosura brenda kufijve të mbyllur, të cilët gjenerojnë energji elektrike të Ripërtërishme për konsum vetanak, dhe të cilët mund ta ruajnë atë energji në objektin e vet për ruajtje ose ta shesin energjinë e prodhuar burimete Ripërtërishme nga ata.
- 1.4. **“ZRRE”** – nënkupton Zyrën e Rregullatorit për Energji të Republikës së Kosovës.
- 1.5. **“Vendim”** – nënkupton një dokument formal me shkrim të lëshuar nga Bordi i ZRRE- së, i cili konstaton përmbushjen e suksesshme nga Aplikuesi të të gjitha kërkesave që dalin nga kjo Rregull.
- 1.6. **“Autorizim”** – nënkupton vendimin e lëshuar nga ZRRE-ja, me të cilin konfirmohet se Aplikuesi ka dorëzuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar sipas Rregullës së Autorizimit për ndërtim, në bazë të të cilit Aplikuesi mund të fillojë ndërtimin e Projektit Energjetik dhe marrjen ose jo të Statusit të Prosumatorit.
- 1.7. **“Baza e energjisë së konsumuar”** – nënkupton energjinë e shpenzuar të paktën gjatë vitit të kaluar.
- 1.8. **“Skema mbështetëse e faturimit neto”** - nënkupton mekanizmin e faturimit që i mundëson një Prosumatori të marrë një kreditim monetar të llogaritur në bazë të zbritjes/netimit së vlerës së energjisë elektrike të konsumuar nga rrjeti dhe vlerës së energjisë elektrike të futur në rrjet brenda një periudhe faturimi.
- 1.9. **“Prosumatorët që veprojnë bashkërisht”** – do të thotë një grup prej të paktën dy Prosumatorëve që veprojnë bashkërisht, të cilët janë të vendosur në të njëjtën ndërtesë ose bllok banesor dhe kanë marrëveshje për të ndarë të drejtën për energjinë elektrike të gjeneruar nga objekti i përbashkët Vetë-gjenerues i Prosumatorit.
- 1.10. **“Skema Mbështetëse e Prosumatorëve”** – do të thotë skema për mbështetjen e Prosumatorëve bazuar në mekanizmin e faturimit-neto siç përcaktohet në këtë Rregull.
- 1.11. **“Tarifa e Prosumatorit”** – do të thotë tarifa që u vendoset Prosumatorëve për të dhënë një kontribut adekuat për kostot që ndërlidhen me shfrytëzimin e rrjeteve përkatëse.
- 1.12. **“Pragu”** – do të thotë maksimumi i kapacitetit Total të instaluar të objektit Vetë-



gjenerues të Prosumatorit, që është i pranueshëm për të marrë pjesë në Skemën Mbështetëse ashtu siç përcaktohet në këtë Rregull.

- 1.13. **“Furnizues”** – do të thotë kompania e licencuar nga ZRRE-ja për të furnizuar me energji elektrike konsumatorët përfundimtar.
 - 1.14. **“Kapaciteti total i instaluar”** - do të thotë shuma e të gjitha kapaciteteve të instaluara të paneleve solare të integruara, ose në rast të ndonjë teknologjie tjetër të ripërtëritshme, shuma e të gjitha kapaciteteve të instaluara të objektit vetë-gjenerues të Prosumatorit.
 - 1.15. **“Periudha e Faturimit”** - është periudha mujore ndërmjet dy leximeve të njehsorit në vendin e Prosumatorit, në bazë të së cilës gjenerohet fatura për atë periudhë nga Furnizuesi.
 - 1.16. **“Konsumatorë të rregulluar”** – janë konsumatorë të energjisë elektrike të cilët furnizohen me energji elektrike nën kushte të shërbimit universal, përkatësisht faturohen me tarifa të përcaktuara nga ZRRE;
 - 1.17. **“Konsumatorë të parregulluar”** – janë konsumatorët e energjisë elektrike të cilët ose nuk kanë të drejtën e shërbimit të furnizimit universal ose që nuk dëshirojnë të ushtrojnë të drejtën e tyre të shërbimit të furnizimit universal dhe që furnizohen me energji elektrike në tregun e lirë.
 - 1.18. **“Prosumator me eksport zero”** – është një Prosumator i cili, duke hequr dorë nga e drejta e tij për të shitur tepriçën e energjisë elektrike duke instaluar pajisje të përshtatshme, nuk lejon që energjia elektrike e vetë-prodhuar të injektohet në rrjetin e shpërndarjes apo transmetimit.
 - 1.19. **“Niveli i ulët i rrjetit shpërndarës”** - është një rrjet shpërndarës me nivel të tensionit 0,4 Kv.
 - 1.20. **“Niveli i mesëm i rrjetit shpërndarës”** – është rrjet shpërndarës me nivel të tensionit 6kV, 10 kV, 20kV dhe 35 kV, dhe
 - 1.21. **“Rrjeti i Transmetimit”** - është një rrjet me nivel të tensionit 110 kV dhe më të lartë.
2. Shprehjet që nuk janë të përcaktuara me këtë Rregull duhet të interpretohet në përputhje me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084, Ligjin për Energjinë Nr. 05/L-081 dhe Ligjin për Energjinë Elektrike nr. 05/L-085.

KREU II

KRITERET E PRANUESHMËRISË DHE SKEMAT MBËSHTETËSE PËRPROSUMATOR

Neni 3

Kriteret e pranueshmërisë

1. Çdo konsumator i energjisë elektrike, i lidhur në rrjetin e shpërndarjes ose transmetimit, ka të



drejtë të bëhet Prosumator.

2. ZRRE pas kërkesës me shkrim të konsumatorit sipas Shtojcës 2 të Rregullës së Autorizimit, lëshon autorizim për ndërtim dhe përcakton Statusin e Prosumatorit pavarësisht nëse është nën apo mbi Prag.
3. Konsumatori i energjisë elektrike merr statusin e Prosumatorit nëse:
 - 3.1. Konsumatori ka pëlqimin ekzistues të operatorit rrjetit;
 - 3.2. Gjeneron energji elektrike duke përdorur teknologjinë e gjenerimit të burimeve të ripërtëritshme me pajisje të reja, me zero orë operim, me përjashtim të objekteve Vetë-gjeneruese të ripërtëritshme që tashmë janë të instaluara, të cilat janë në operim në momentin e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulle;
 - 3.3. Objekti vetë-gjenerues nga burimet e ripërtëritshme të konsumatorit është i lidhur me instalimet e brendshme të konsumatorit;
 - 3.4. Kapaciteti total i instaluar i objektit Vetë-gjenerues të konsumatorit me Burime të Ripërtëritshme është i barabartë ose më i vogël se kapaciteti i kontraktuar i lidhjes së konsumatorit;
 - 3.5. Në rastin e Objekteve Vetë-gjeneruese me Burime të Ripërtëritshme të ndërtuara para hyrjes në fuqi të këtij Rregulle, ZRRE-ja do të shqyrtojë çdo rast individualisht;
 - 3.6. Sasia vjetore e energjisë elektrike të tepërt të injektuar në rrjet është më e ulët se sasia e energjisë elektrike të tërhequr nga rrjeti gjatë vitit të njëjtë. Kjo dispozitë nuk zbatohet në vitin e parë kalendarik të pjesshëm.

Neni 4

Aplikimi për t'u bërë Prosumator

1. ZRRE lëshon vendimin për autorizim për ndërtim dhe për miratimin ose refuzimin e Statusit të Prosumatorit për konsumatorët që plotësojnë ose jo kërkesat sipas Nenit 3, paragrafit 3 i kësaj Rregulle.
2. Vendimi i ZRRE-së, merret brenda tridhjetë (30) ditësh nga data e aplikimit.
3. Prosumatorët, mund të aplikojnë në çdo kohë për modifikimin e autorizimit të statusit të tyre nëse ndryshohen kushtet teknike, si: ndryshimi i kapacitetit të kontraktuar të kyçjes, ndryshimi i konsumit, etj.
4. Prosumatorët jashtë skemës mbështetëse, me përjashtim të prosumatorëve me eksport Zero, pas marrjes së autorizimit për ndërtim duhet të dërgojë në ZRRE kontratën e nënshkruar me furnizuesin për shitjen e tepërcave, pa i zbuluar informatat konfidenciale.

Neni 5

Kriteret për përfshirjen në Skemat Mbështetëse

1. Konsumatorët e energjisë elektrike kanë të drejtë të instalojnë në mjediset e tyre një objekt



gjenerues që prodhon energji elektrike të ripërtërishme për konsumin e vet dhe ata mund të zgjedhin të mbajnë statusin e konsumatorëve prodhues, përmes një Skeme Mbështetëse për vet-konsum, të specifikuar me këtë Rregull.

2. Konsumatorët e energjisë elektrike të kyçur në tensionin e ultë të rrjetit të shpërndarjes (0.4kV), që janë konsumator familjar kanë të drejt të vendosin kapacitete gjeneruese për vet-konsum me një fuqi të instaluar të njësisë së prodhimit në bazë të energjisë së konsumuar dhe në bazë të Pëlqimit Elektroenergjetik që nuk kalon 7 kW.
3. Konsumatorët e energjisë elektrike të kyçur në tensionin e ultë të rrjetit të shpërndarjes (0.4kV), që janë konsumator jo-familjar dhe të cilët nuk faturohen për fuqinë aktive të angazhuar, kanë të drejt të vendosin kapacitete gjeneruese për vet-konsum me një fuqi të instaluar të njësisë së prodhimit në bazë të energjisë së konsumuar dhe në bazë të Pëlqimit Elektroenergjetik që nuk kalon 15 kW.
4. Konsumatorët e energjisë elektrike të kyçur në tensionin e ultë të rrjetit të shpërndarjes (0.4kV), që janë konsumator jo-familjar që kanë matje dhe faturim për fuqinë aktive të angazhuar, kanë të drejt të vendosin kapacitete gjeneruese për vet-konsum me një fuqi të instaluar të njësisë së prodhimit në bazë të energjisë së konsumuar dhe në bazë të Pëlqimit Elektroenergjetik por që nuk kalon pragun prej 100 kW.
5. Kurdo që fuqia e angazhuar e kalkuluar në bazë të të dhënave të konsumit vjetor për konsumatorët e kyçur në nivelin e tensionit 0.4kV, është më e ulët se ose e barabartë me fuqinë e kontraktuar, autorizimi për kapacitetin e lejuar për statusin e Prosumatorit do të jepet në bazë të nivelit më të ulët të këtyre vlerave: fuqia e llogaritur bazuar në të dhënat e konsumit vjetor ose Pragu.
6. Konsumatorët e energjisë elektrike të kyçur në tensionin e mesëm të rrjetit të shpërndarjes (6kV, 10kV, 20kV dhe 35kV) dhe në rrjetin e transmetimit, që janë konsumator jo-shtëpiak kanë të drejt të vendosin kapacitete gjeneruese për vet-konsum me një fuqi të instaluar të njësisë së prodhimit në bazë të fuqisë mesatare të angazhuar gjatë periudhës 12 mujore dhe në bazë të Pëlqimit Elektroenergjetik që nuk kalon pragun prej 200 kW.
7. Përrjashtimisht par. 2 të këtij Neni, për konsumatorët e rijnë pavarësisht nga niveli i tensionit, fuqia e lejuar ipet si 50% e fuqisë të lejuar sipas pëlqimit elektroenergjetik, me mundësi që vitet e ardhshme konsumatori të aplikojë për rishikim bazuar në aktivitetin e tij.
8. Skema Mbështetëse për konsumatorët energjisë elektrike të nivelit të ulët dhe të mesëm të rrjetit të shpërndarjes dhe rrjetit të transmetimit sipas par. 2, 3, 4 dhe 6 të këtij Neni do të jetë me Neto Faturim.
9. Prosumatorët të cilat gjatë vitit kalendarik injektojnë më tepër se 10% të energjisë që e konsumojnë gjatë vitit të njëjtë, do ta humb Statusin e Prosumatorit në momentin e vërtetimit të tij nga ana e operatorit të shpërndarjes apo të transmetimit në varësisht prej nivelit të kyçjes.

Neni 6

Metodologjia e llogaritjes se kapacitetit të lejuar për skemë mbështetëse

Për konsumatorët familjar dhe për konsumatorët jo-familjar të kyçur në nivelin 0.4 kV të cilët nuk



faturohen për fuqinë e angazhuar, kalkulimi i fuqisë së lejuar bëhet sipas formulës:

$$P_{mest} = \frac{\sum_{i=1}^{12} W_i}{n * C}$$

Për konsumatorët jo-familjar në 0.4kV të cilët faturohen edhe për fuqinë aktive të angazhuar, për konsumatorët e kyçur në nivelin 6kV, 10kV, 20kV dhe 35kV, si dhe për konsumatorët e kyçur në nivel të transmetimit, kalkulimi i fuqisë së lejuar bëhet sipas formulës:

$$P_{mest} = \frac{\sum_{i=1}^{12} P_{max_i}}{m}$$

Ku:

P_{mest} është fuqia mesatare vjetore e angazhuar -

kW

P_{max_i} fuqia maksimale e rexhistruar në maksigraf gjatë muajit i- kW

W_i energjia e konsumuar gjatë muajit i - kWh

n – numri i orëve në vit – (8760h për një vit)

m – numri i muajve në vit - 12

C – Vlera e koeficientit për teknologjinë PV është – 0.156,

ndërsa për teknologji tjera duhet të vlerësohet individualisht duke u bazuar në koeficientin e prodhimit sipas projektit specifik

i – numri rendor i muajit të vitit

Për konsumatorët familjar dhe jo-familjar të kyçur në 0.4kV, kurdo që:

$$P_{mest} < P_{pelqim}$$

Autorizimi ipet për P_{mest} , në të kundërtën autorizimi ipet sipas P_{pelqim}

Neni 7

Skema mbështetëse e faturimit neto

1. Me kusht që të plotësohen të gjitha kriteret sipas Nenit 3, paragrafi 3 i kësaj Rregulle, dhe nëse kapaciteti total i instaluar i objektit vetë-gjenerues është deri në dhe i barabartë me Prapun, konsumatori i energjisë elektrike ka të drejtë të pranohet në Skemën Mbështetëse të Faturimit Neto ashtu siç përcaktohet në këtë Rregull.
2. Një Prosumator brenda Skemës Mbështetëse të Faturimit Neto:
 - 2.1. Ka të drejtë të nënshkruajë kontratën e furnizimit për Prosumatorët brenda Skemës Mbështetëse të Faturimit Neto me Furnizuesin e tij. Furnizuesi është i detyruar t'ia ofrojë këtë kontratë Prosumatorit sipas kësaj Rregulle.
 - 2.2. Ka të drejtë të kompensohet për energjinë elektrike të tepërt ashtu siç përcaktohet në Nenin 9 të kësaj Rregulle.
3. Konsumatorët e energjisë elektrike që kanë marrë Statusin e Prosumatorit dhe janë të pranuar në Skema tjera Mbështetëse, si p.sh. Matje-neto, kanë të drejtë të aplikojnë dhe të pranohen në Skemën Mbështetëse të Faturimit Neto, ashtu siç përcaktohet në këtë Rregull dhe të



ushtrojnë të drejtat e Skemës Mbështetëse të Faturimit Neto për periudhën e mbetur që është diferenca midis 12 (dymbëdhjetë) viteve dhe kohës së kaluar duke i gëzuar të drejtat sipas një skeme tjetër mbështetëse.

4. Konsumatorët e energjisë elektrike që tashmë kanë instaluar objekte vetë-gjeneruese, por dëshirojnë të hyjnë në Skemën Mbështetëse e Faturimit Neto sipas kësaj Rregulle, duhet të aplikojnë për Autorizim për ndërtim, në përputhje me kërkesat e Rregullës së Procedurës së Autorizimit për e Ndërtimin e Kapaciteteve të Reja Gjeneruese.
5. Konsumatori i energjisë elektrike me Statusin e Prosumatorit sipas Skemës Mbështetëse të Faturimit Neto nënshkruan kontratën me Furnizuesin sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në këtë Rregull.
6. Marrëveshjet për Blerje të Energjisë Elektrike kanë një kohëzgjatje deri në dymbëdhjetë (12) vitesh, për Prosumatorët të cilët marrin Statusin e tillë.
7. Furnizuesi me Shërbim Universal është i obliguar që brenda tridhjetë (30) ditëve nga miratimi i kësaj Rregulle të dorëzojnë për miratim në ZRRE formatin e kontratës së furnizimit për Prosumatorët brenda Skemës Mbështetëse të Faturimit Neto.

Neni 8

Prosumatorët jashtë Skemës Mbështetëse

1. Prosumatorët jashtë skemës mbështetëse janë prosumatorët:
 - 1.1. Prosumatorët jashtë Skemës Mbështetëse të Faturimit Neto dhe
 - 1.2. Prosumatorët jashtë Skemës Mbështetëse.
2. Prosumatorët jashtë Skemës Mbështetëse të Faturimit Neto, janë:
 - 2.1. Prosumatorët me kapacitet Total të instaluar të objektit Vetë-gjenerues mbi Prag;
 - 2.2. Prosumatorët me kapacitet Total të instaluar të objektit Vetë-gjenerues deri në dhe të barabartë me Pragun, por nuk dëshirojnë të jenë nën Skemën Mbështetëse të Faturimit Neto;
 - 2.3. Prosumatorët që veç kanë ushtruar të drejtën për skema të tjera mbështetëse;
 - 2.4. Konsumatorët e energjisë elektrike me statusin e Prosumatorit brenda Skemës Mbështetëse të Faturimit Neto dhe të cilët kanë vendosur të largohen nga Skema Mbështetëse e Faturimit Neto ose ndonjë skemë tjetër mbështetëse.
3. Një Prosumator jashtë Skemës Mbështetëse:
 - 3.1. Nuk ka të drejtë të ndajnë kapacitetin brenda dhe jashtë skemës mbështetëse;
 - 3.2. Mund t'ia shesë energjinë elektrike Furnizuesve në bazë të një kontrate të ndërsjellë.
 - 3.3. Për konsumatorët e energjisë elektrike të kyçur në tensionin e ulët (0.4kV) të rrjetit të shpërndarjes, kapaciteti i lejuar për autorizim për vet-konsum vlerësohet në bazë të vlerës më të ulët mes energjisë së konsumuar dhe në bazë të Pëlqimit Elektroenergjetik.



3.4. Për konsumatorët e energjisë elektrike të kyçur në tensionin e mesëm të rrjetit të shpërndarjes (6kV, 10kV, 20kV dhe 35kV) dhe në rrjetin e transmetimit, kapaciteti i lejuar për autorizim për vet-konsum vlerësohet në bazë të vlerës më të ulët mes fuqisë mesatare të angazhuar gjatë periudhës 12 mujore dhe në bazë të Pëlqimit Elektroenergjetik.

3.5. Për të marr statusin e konsumatorit vet-prodhues jashtë skemës mbështetëse, konsumatori pas marrjes së autorizimit për ndërtim duhet të dërgojë në ZRRE kontratën e nënshkruar me furnizuesin ndër të tjera duke përfshirë edhe menaxhimin e tepricave, pa i zbuluar informatat konfidenciale.

3.6. Prosumatorët me eksport zero janë të përjashtuar nga detyrimet e përcaktuara në këtë Nen.

4. ZRRE-ja, mund të rregullojë përkohësisht çmimin e tepricës së energjisë elektrike për Prosumatorët jashtë Skemës Mbështetëse të Faturimit Neto.

KREU III SKEMA MBËSHTETËSE E FATURIMIT NETO dhe kostot tjera

Neni 9 Llogaritja e Skemës Mbështetëse të Faturimit Neto

1. Teprica e energjisë elektrike që nuk konsumohet nga Prosumatori në kuadër të Skemës Mbështetëse të Faturimit Neto do të merret nga Furnizuesi, me të cilin Prosumatori ka një kontratë furnizimi për Prosumatorët brenda Skemës Mbështetëse të Faturimit Neto.
2. Sasia e energjisë elektrike të tërhequr dhe sasia e energjisë elektrike të tepërt përcaktohen në bazë të leximeve të njehsorëve në pikën matëse.
3. Prosumatorët kanë të drejtën e kompensimit për energjinë elektrike të tepërt përmes një kreditimi monetar në Euro. Kompensimi do të llogaritet në bazë të netos së vlerës monetare të energjisë elektrike, vetëm për komponentët e energjisë, të tërhequra nga rrjeti dhe vlerës monetare të tepricës së energjisë elektrike të futur në rrjet brenda një Periudhe Faturimi e cila do të merret parasysh kur të përgatiten faturat e energjisë elektrike nga Furnizuesi.
4. Çmimi për përcaktimin e vlerës monetare të energjisë elektrike të tepërt të futur në rrjet do të jetë çmimi i komponentit të energjisë dhe do të llogaritet për çdo periudhë tarifore sipas formulës së mëposhtme:

$$C_{tepert}^{PT} = C \times C_{furnizuar}^{PT}$$

ku:

C_{tepert}^{PT} – Çmimi për energjinë elektrike të tepërt gjatë periudhës tarifore PT dhe brenda periudhës së faturimit;

$C_{furnizuar}^{PT}$ – Çmimi i furnizimit me energji elektrike i llogaritur nga ZRRE gjatë periudhës tarifore PT (vetëm komponenti energjetik i çmimit të furnizimit me energji elektrike, pa tarifë dhendonjë pagesë dhe taksë tjetër) brenda periudhës së



faturimit.

- C** – Koeficienti i çmimit. Vlera e koeficientit është 0,85 për konsumatorëte kyçur në nivelin e tensionit 0.4kV, ndërsa 0.80 është për konsumatorët e kyçur në rrjetin e tensionit të mesëm dhe në transmetim. Këta koeficiente aplikohen për konsumatorët e rregulluar me qëllim të menaxhimit të kostove administrative dhe kostove të jo-balanceve nga FSHU. Vlera e koeficientit C do të rishikohet periodikisht nga ZRRE-ja (të paktën çdo dy vjet). Çdo ndryshim i mundshëm i koeficientit do të bëhet me vendim të ZRRE-së, brenda përcaktimeve të kësaj Rregulle.
- Tek konsumatorët jashtë Skemës Mbështetëse vlera e koeficientit C mund të negociohet ndërmjet konsumatorit dhe furnizuesve, por vlera e koeficientit C nuk mund të jetë më e ulët se 0,70.
5. Nëse vlera monetare e energjisë elektrike të tepërt është më e madhe se vlera monetare e komponentit të energjisë së tërhequr nga rrjeti për të njëjtën periudhë Faturimi, kreditimi monetar në Euro i llogaritur në bazë të Netos së dy (2) vlerave të mëparshme të energjisë elektrike, do të transferohet në periudhën tjetër të Faturimit. Kreditimi monetar duhet të shfrytëzohet nga Prosumatori brenda një periudhe prej gjashtë (6) muajsh, përveç periudhës së parë të shfrytëzimit kur mund të jetë më e shkurtër se gjashtë (6) muaj, dhe në fund të kësaj periudhe vlera monetare rivendoset në zero (0).
 6. Kreditimi monetar, sipas paragrafit 5 të këtij Neni, do të rivendoset në datën 1 janar dhe 1 korrik të çdo viti.
 7. Nëse pajisjet e konsumatorit-prodhues fillojnë të punojnë pas fillimit të periudhës llogaritëse, e cila në atë rast është më e shkurtër se gjashtë muaj, ajo do të zgjasë deri në përfundimin e periudhës llogaritëse nga paragrafi (6) i këtij Neni.
 8. Vlera e ngarkesës së rrjetit e faturës së energjisë elektrike dhe vlera e ngarkesave tjera nuk netohet, dhe baza për llogaritjen e tyre është shuma e energjisë elektrike të injektuar.
 9. Furnizuesi lëshon faturën për Prosumatorin ku të gjithë artikujt si: komponenti i energjisë së reduktuar; ngarkesa e pa reduktuar e rrjetit; komponenti i tarifës i pa reduktuar, do të prezantohen qartë dhe në mënyrë transparente.
 10. Furnizuesi i Shërbimit Universal është i detyruar të publikojë në faqen e tij të internetit formularin standard të Kërkesës për lidhjen e një kontrate furnizimi për Prosumatorët brenda Skemës Mbështetëse të Faturimit Neto jo më vonë se tridhjetë (30) ditë nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulle.

Neni 10

Kostot e Prosumatorëve për shfrytëzimin e rrjetit

1. Prosumatorët duhet të kompensojnë në mënyrë adekuate koston e ndikimit në sistemin energjetik dhe në rrjet.
2. Tarifa e Prosumatorëve paguhet nga të gjithë Prosumatorët, pavarësisht nëse janë apo jo pjesë e Skemës Mbështetëse, në mënyrë që të reduktohet në mënyrë adekuate ndikimi i tyre negativ



në kostot e sistemit energjetik dhe të rrjetit.

3. Tarifat e Prosumatorëve që do të aplikohen ndaj energjisë së injektuar në rrjet do të jenë në harmoni me komponentën tarifore për Prodhimin e kësaj në Shpërndarjes sipas strukturës tarifore të OST/OT.
4. Prosumatorët do të paguajnë kostot për energjinë e injektuar për Tarifën e Operatorit të Sistemit (TOS) dhe Tarifën për Operatorit të Tregut (TOT) duke përfshirë marzhën e OSSH-së prej 3% të tarifave totale të ngarkuara (TOS + TOT). Kjo marzhë ka të bëjë me shërbimet e leximit dhe faturimit që kryhet nga OSSH për OST dhe OT për konsumatorët e kësaj në OSSH.
5. Kostot që Prosumatorët kanë paguar OSSH-së, për TOS dhe TOT do të transferohen te OST/OT në faturimet mujore ndërmjet OSSH-së dhe OST/OT-së, duke mos përfshirë kostot që rezultojnë nga aplikimi i marzhës.
6. Tarifa e OST/OT do të azhurnohen gjatë shqyrtimeve tarifore nga Rregullatori.

Neni 11

Obligimet e Operatorëve të Rrjetit

1. Operatorët e rrjetit do të ndërmarrin hapat e duhur për të zhvilluar infrastrukturën e rrjetit për të lejuar operimin e sigurt sa i përket pranimin të energjisë nga Prosumatorët.
2. Shqyrtimit të aplikacionit nga Prosumatorët i jepet përparësi nga operatori i rrjetit, brenda 30 ditësh kalendarike nga data e aplikimit.
3. Kushtet e përgjithshme për qasje dhe shfrytëzim të rrjetit zbatohen për marrëdhëniet ndërmjet konsumatorit dhe operatorit të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike.
4. Pas kërkesës për pranim teknik të objektit Vetë-gjenerues, operatori i rrjetit do të lëshojë certifikatën e pranimin në afat prej shtatë (7) ditësh kalendarike.

Neni 12

Kërkesat teknike minimale për Prosumatorët

1. Pranë ose në pikën e lidhjes me rrjet do të vendoset një ndërprerës i shkyçjes, i cili mundëson shkyçjen e objektit Vetë-gjenerues të Ripërtëritshëm nga operimi paralel me rrjet për arsye sigurie.
2. Operimi i objektit Vetë-gjenerues të Prosumatorëve në regjimin ishull është i ndaluar. Ndalja e objektit Vetë-gjenerues të Prosumatorëve në rast të humbjes së tensionit të rrjetit duhet të jetë automatike dhe duhet të vendosen pajisjet e duhura mbrojtëse.
3. Në pikën e kyçjes së një Prosumatori, do të instalohet njehsori dy-drejtimesh për të regjistruar injektimin e energjisë elektrike në rrjet dhe për të regjistruar rrjedhjen e energjisë elektrike nga rrjeti.



4. Përveç njëorit dy drejtimesh, tek Prosumatori duhet vendosen edhe një apo më shumë matës të energjisë elektrike varësisht nga mënyra e kyçjes së Prosumatorit në rrjet, për të evidentuar prodhimin e gjithmbarshëm të energjisë elektrike.
5. Kostot e blerjes dhe instalimit të njehsorëve barten nga Prosumatori, sipas Metodologjisë së Taksave për Kyçje të aprovuar nga ZRRE.
6. Nëse ndikimi negativ në rrjet është mbi kufijtë e lejuar, operatori i rrjetit ka të drejtë të plotë të kërkohet ndaljen e menjëhershme të objektit Vetë-gjenerues të Prosumatorit. Në rast se ndikimi negativ vazhdon të mbizotërojë, operatori i rrjetit do të ndërpres dhe çaktivizojë operimin e mëtejshëm paralel të objektit Vetë-gjenerues të Prosumatorit me rrjet derisa arsyet për shkyçje të eliminohen në përputhje me përkufizimet përkatëse të dhëna në kodin përkatës të rrjetit. Vendimi për një shkyçje të tillë duhet të arsyetohet me arsyetim teknik dhe t'i dorëzohet me shkrim Prosumatorit nga operatori i rrjetit menjëherë.
7. Operatori i rrjetit do të ketë qasje të plotë dhe të pakufizuar në ndërprerësin dhe pajisjet e lidhura me të.
8. Prosumatori është i obliguar të gjenerojë energji elektrike që përmbushë kërkesat e cilësisë për energji elektrike të përcaktuara me kodet përkatëse të rrjetit për sistemin energjetik të Kosovës, dhe sipas kriterëve teknike të miratuara nga ZRRE.
9. Prosumatorët dhe prosumatorët që veprojnë bashkërisht duhet të sigurohen që të gjitha instalimet e brendshme të objekteve Vetë-gjeneruese me Burime të Ripërtërishme janë bërë në përputhje me legjislacionin përkatës të Kosovës dhe standardet teknike të aplikueshme.
10. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të hartojë kriteret teknike, dhe do ti dërgojë për aprovim në ZRRE brenda 30 dite kalendarike nga miratimi i kësaj Rregulle.

Neni 13 Kostoja e kyçjes në rrjet

Kostot për instalimin e pajisjeve matëse të nevojshme do të barten nga Prosumatori.

KREU IV PROSUMATORËT QË VEPROJNË BASHKËRISHT

Neni 14 Instalimi i teknologjisë së ripërtërishme në ndërtesat me shumë apartamente

Çdo dy ose më shumë konsumatorë fundorë që ndodhen në të njëjtin ndërtesë ose bllok banesor mund të bëhen Prosumator të autorizuar që veprojnë bashkërisht, nëse plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

- 1.1. të jenë pronarë të pikave të kyçjes që ndodhen në të njëjtën ndërtesë ose bllok banesor;
- 1.2. të mos kryejnë gjenerimin dhe shkëmbimin e energjisë elektrike si veprimtari kryesore tregtare ose profesionale;



- 1.3. kanë nënshkruar një kontratë ndërmjet vete me një metodologji të përcaktuar për ndarjen egjenerimit kolektiv të energjisë elektrike;
- 1.4. i kanë dhënë një autorizim personit/subjektit përfaqësues për menaxhimin e autorizimit të të gjitha subjekteve që i përkasin Prosumatorëve që veprojnë bashkërisht dhe për të kërkuar dhe marrë përfitimet e ofruara nga skema mbështetëse;
- 1.5. kapaciteti i instaluar i objekteve Vetë-gjeneruese të Prosumatorëve që Veprojnë Bashkërisht nuk mund të jetë më i madh se shuma totale e kapaciteteve të kyçjes së të gjithë Prosumatorëve individualë që veprojnë bashkërisht.
2. Të drejtat dhe obligimet e konsumatorëve fundorë mbeten të pandikuara, dhe anëtarët e Prosumatorëve që veprojnë bashkërisht nuk u nënshtrohen kushteve dhe procedurave të paarsyetuara ose diskriminuese që pengojnë pjesëmarrjen e tyre në gjenerimin e përbashkët.
3. Prosumatorët që veprojnë bashkërisht ruajnë të drejtat dhe obligimet e tyre si blerës individualë.
4. Operatori i sistemit të shpërndarjes dhe entiteti që përfaqëson Prosumatorët që veprojnë bashkërisht do të lidhin një kontratë dhe do të pajtohen në lidhje me leximin e njehsorëve, ndarjen e energjisë elektrike dhe llogaritjen e energjisë elektrike.
5. Operatori i sistemit të shpërndarjes mbledh të gjitha të dhënat e nevojshme të faturimit dhe i dorëzon këto të dhëna Furnizuesit me të cilin Prosumatorët që veprojnë bashkërisht kanë një kontratë.
6. Faturimi i çdo anëtari të Prosumatorëve që veprojnë bashkërisht, do të kryhet nga Furnizuesi në të njëjtën mënyrë si për çdo Prosumator individual.

KREU V

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE DHE KALIMTARE

Neni 15

Aplikimet ekzistuese

1. Nëse një aplikues ka marrë Autorizim të statusit të konsumatorit për vet-prodhim nga ZRRE-ja sipas Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse para hyrjes në fuqi të kësaj Rregulle, aplikuesi i tillë trajtohet në përputhje me Rregullën në fuqi në kohën e aplikimit.
2. Çdo Aplikim pas hyrjes në fuqi të këtij Rregulli shqyrtohet nga ZRRE sipas këtij Rregulle.

Neni 16

Mbledhja e të dhënave



1. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes duhet t'i dorëzoj në ZRRE të dhënat për energjinë elektrike të gjeneruar dhe të konsumuar nga Prosumatorët.
2. ZRRE-ja do të krijojë një regjistër të vetë-konsumatorëve të Burimeve të Ripërtëritshme, i cili do të përfshijë, *ndër të tjera*, informatat e mëposhtme për:
 - 2.1. Emri dhe adresa e Prosumatorit;
 - 2.2. Kategoria e Prosumatorit;
 - 2.3. Lloji i teknologjisë së përdorur në objektin Vetë-gjenerues;
 - 2.4. Vendndodhja e objektit Vetë-gjenerues;
 - 2.5. Kapaciteti total i instaluar i objektit Vetë-gjenerues të Prosumatorëve;
 - 2.6. Kapaciteti i kontraktuar i kyçur i konsumatorit.

Neni 17 Ndryshimet/Plotësimet

1. ZRRE-ja mund të ndryshojë ose modifikojë çdo dispozitë të kësaj Rregulle.
2. Procedurat për modifikimin ose ndryshimin e kësaj Rregulle do të jenë të njëjta si për miratimin e saj.

Neni 18 Interpretimi

Në rast të ndonjë pasigurie në lidhje me dispozitat e kësaj Rregulle, Bordi do të nxjerr informata shpjeguese.

Neni 19 Shfuqizimi

Me fillimin e zbatimit të kësaj Rregulle do të shfuqizohen Nenet 18, 19 dhe 20 të Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse.

Neni 20 Gjuha zyrtare

Kjo rregull publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës. Në rast mospërputhjesh ndërmjet versioneve, do të mbizotëroj versioni në gjuhën Shqipe.

Neni 21 Hyrja në fuqi


1. Rregulla hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së.




2. Zbatimi i kësaj Rregulle do të filloj pas plotësimit të kushteve ligjore të Nenit 14 të Ligjit Nr. 05/L-100 për Ndihmën Shtetërore dhe pas aprovimit të kriterëve teknike sipas par. 10 të Nenit 12 të kësaj Rregulle.
3. Rregulla publikohet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Bordi i Rregullatorit:


Ymer Fejzullahu, Kryesues


Lutfije Dervishi, anëtare


Gani Buçafaj, anëtar


Arta Isuli, anëtare


Adnan Preniqi, anëtar